# A K T - T H E M E L I M I

## I SHOQERISE " GUCI " SH.P.K

NENI 1

NAIM CARA, i biri i Bajramit, dhe i Farijes, i datelindjes 1963, lindur ne Burrel dhe banues ne Lagjen "Pjeter Budi" Burrel, sot me date 26.03.1998 ka vendosur qe shoqeria e tij e quajtur "GUCI " sh.p.k te marre formen e nje Shoqerie Tregtare me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 dhe ligjin Nr.7667 date 28.01.1993.

NENI 2

Shoqeria vepron ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne perputhje me dispozitat e statutit qe i bashkalidhet ketij akti themelimi.

NENI 3

Emri i shoqerise eshte " GUCI " SH.P.K.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :
Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh, ndertime civile dhe ekonomike, ndertime rrugesh kategoria V, IV, ndertime veprash arti te vogla, te mesme , te medha, tunele, ndertime ujesjellesa kanalizime, ndertim vepra kullimi, ujitje toke, impiante vaditese, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, mirembajtje dhe zhvillim dekori ne mjedise urbane. Ne fushen e import eksportin e tregti me shumice e pakice te lendeve te para, te ndertimit ,te mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, pajisjeve elektrike, elektronike, hidrosanitare, pjeseve te kembimit te gjitha llojeve, mobiljeve, te karburanteve e nenprodukteve te tyre, te cigareve duhanit, konfeksioneve, materialeve plastike, makinerive, duraluminit, bimeve medicinale, parfumerise, pijeve te ndryshme alkolike e freskuese.Krijimin e agjencive te spedicionit,te transportit te pasagjereve e mallrave per shoqerine e te tretet, hapjen e bar restoranteve, parkimeve, agjenci komisionere, ndermjetesimi dhe konsulence ne fusha te ndryshme.

NENI 5

Selia e shoqerise eshte ne Lagjen "Pjeter Budi" Burrel.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000(njeqind mije) Leke.Shuma e derdhur per formimin e kapitalit themeltar do te vertetohet me ane te nje dokumenti te leshuar nga banka.

NENI 7

Ortak i vetem i shoqerise eshte zoti NAIM CARA.

NENI 8

Administratori i shoqerise eshte zoti NAIM CARA.

NENI 9

Kohezgjatja e aktiviteti te shoqerise eshte mbi 15 vjet.

PER SHOQERINE "GUCI"SH.P.K

ORTAKU I VETEM

NAIM CARA

S T A T U T I

I SHOQERISE " GUCI " SH.P.K

I.KRIJIMI,FORMA,EMERTIMI,OBJEKTI,SELIA,
DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " GUCI " sh.p.k me seli ne Burrel, eshte krijuar sipas akt-themelimit qe i bashkengjitet ky statut i perpiluar dhe i nenshkruar nga :

1.NAIM CARA,i biri i Bajramit dhe i Farijes, i datelindjes 1963 , banues ne Burrel ne Lagjen "Pjeter Budi".

NENI 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarine tregtare ne Shqiperi ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dispozitat e ketij statuti.

Shoqeria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit te saj ne zyren e regjistrit tregtar te Gjykates se rrethit Tirane.

Shoqeria ka vulen e vet me emrin e saj.

NENI 3

Emertimi i shoqerise eshte " GUCI "sh.p.k.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:
Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh, ndertime civile dhe ekonomike, ndertime rrugesh kategoria V,IV, ndertime veprash arti te vogla, te mesme, te medha, tunele, ndertime ujesjellesash kanalizimesh, ndertime vepra kullimi, ujitje toke, impiante vaditese, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, mirembajtje dhe zhvillim dekori ne mjedise urbane.Ne fushen e import eksportit, tregtise me shumice dhe pakice te lendeve te para, te materialeve te ndertimit, te malrave industriale, ushqimore, bujqesore, pajisjeve elektrike, elektronike, hidrosanitare, pjeseve te kembimit te gjitha llojeve, mobiljeve, karburanteve e nenprodukteve te tyre, te cigareve, duhanit, konfeksioneve, materialeve plastike, makinerive, duraluminit, bimeve medicinale, parfumerise, pijeve te ndryshme alkolike dhe freskuese. Krijimin e Agjencive te spedicionit, te transportit te pasagjereve dhe mallrave per shoqerine e te tretet, hapjen e bar restoranteve, parkimeve, agjenci komisionere, ndermjetesimi dhe konsulence ne fusha te ndryshme.

NENI 5

Selia e shoqerise eshte ne Lagjen "Pjeter Budi" Burrel.

Shoqeria mund te hape filiale ne te gjitha rrethet e vendit ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

NENI 6

Kohezgjatja e shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe kohore prej 15 vjet duke filluar nga data e regjistrimit te saj. Kjo periudhe mund te shkurtohet ne rast se shoqeria prishet perpara kohe.

II.KAPITALI THEMELTAR ,KONTRIBUTI
PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke,i ndare perkatesisht ne 100 kuota ku cdo kuote ka vleren e 1000 lekeve.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi i Ortakut te Vetem.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie,ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

NENI 10

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete me miratimin e Ortakut te Vetem.

NENI 11

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar gjithmone duhet te vertetohet me Akt - Noterial.

III.MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI
KOMPETENCA DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 12

Te gjitha vendimet e shoqerise merren nga Ortaku i Vetem.

NENI 13

Shoqeria administrohet nga administrator qe mund te jete person fizik ose mund te jete Ortaku i Vetem.Me vendim te Ortakut te Vetem emerohet administrator zoti NAIM CARA.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te githa veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj,nepermjet kompetencave qe i jane percaktuar ne kete statut. Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratimin e Ortakut te Vetem. Emerimi i tij behet per 3 (tre) vjet financiare, dhe mund te rizgjidhet me perjashtim te rasteve te doreheqjes dhe shkarkimit per paaftesi.

## NENI 14

Administratori eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht sipas rastit, ndaj shoqerise apo te treteve, per shkelje te ligjeve, te dispozitave te ketij statuti apo per faje gjate administrimit te shoqerise ose te daljes jashte kompetencave te ngarkuara.

## NENI 15

Disa nga kompetencat qe i jepen administratorit jane :

- Te siguroje drejtimin dhe mbarevajtjen e mire te shoqerise.
- Te administroje pasurine e shoqerise.
- Te perfaqesoje shoqerine ne maredheniet me te tretet.
- Te perfaqesoje shoqerine perpara organeve gyqesore dhe administrative ose autorizon persona te tjere kompetente.
- Kryen veprime juridike ne emer dhe per llogari te shoqerise me te tretet si : lidh kontrata, ben celje te kredive, kryen veprime te ndryshme bankare e doganore etj,brenda limitit qe i lejon Ortaku i Vetem.

## NENI 16

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i cili emerohet dhe shkarkohet nga Ortaku i Vetem.

# IV.VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE

## NENI 17

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 dhjetor.Perjashtimisht viti i pare financiar ka filluar diten e themelimit si person juridik.

## NENI 18

Llogarite vjetore , inventari, raporti mbi veprimtarine e vitit financiar te hartuara nga administratori,nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Ortaku i Vetem.

## NENI 19

Bilanci vjetor i veprimtarise se shoqerise nxirret brenda 31 marsit te vitit pasardhes.

## NENI 20

Fitimet neto te realizuara nga veprimtaria e shoqerise mbasi zbriten te githa shpenzimet e kryera dhe 5% qe mbahen per fondin rezerve,Ortaku i Vetem vendos per qellimin e perdorimit si :per

investim,nxitje ekonomike,reklame treytare ose per qellime te tjera.

NENI 21

Shoqeria ka te drejten e perdorimit lirisht te fitimeve dshe te disponimit lirisht te pasurise se saj ne perputhe me qellimin e objektit te veprimtarise qe kryen.

NENI 22

Detyrimet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise ajo i mbulon nga fondi rezerve ose nga shumat suplementare.

NENI 23

Shoqeria gezon te gjitha te drejtat dhe mbrojtjen e pasurive te saj nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

V. PUNESIMET NE SHOQERI

NENI 24

Per punonjesit qe do te punesohen ne shoqeri marredheniet juridike midis shoqerise dhe te punesuarve do te rregullohen nepermjet kontrates se punes ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe kodin e punes.

NENI 25

Shoqeria merr persiper te derdhe rregullisht te gjitha detyrimet ,gjithashtu dhe kontributet per sigurimin e te punesuarve te saj ne organet kompetente perkatese ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

VI. PRISHJA E SHOQERISE, LIKUIDIMI

NENI 26

Shoqeria prishet perpara kohe kur :
- Aktiviteti ekonomik i saj disa vjet rradhazi eshte me humbje.
- Per aresye te parashikuara ne ligj.
- Ne cdo rast tjeter me vendim te Ortakut te Vetem.

NENI 27

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e marrjes se vendimit per prishjen e saj,per kryerjen e ketij procesi Ortaku i Vetem emeron nje ose dy likuidatore te cilet paraqesin raportin dhe bilancin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te shoqerise te cilat shqyrtohen nga Gjykata e rrethit Tirane.

## VII. KUSHTE TE TJERA

### NENI 28

Te gjitha vendimet e Ortakut te Vetem registrohen ne librin e vecante qe mbahet ne seline e shoqerise.

### NENI 29

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgidhen me mirekuptim organi kompetent per zgjidhjen e tyre eshte gjykata .

### NENI 30

Ky statut eshte hartuar ne baze te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit Nr. 7667 te dates 28.01.1993.

PER SHOQERINE " GUCI " SH.P.K

O R T A K U I V E T E M

NAIM CARA